



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Njërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1756
Datë: 14/11/2024RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË
DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Departamenti i Komunikacionit / Komunikacion rrugor
Titulli i punimit	“Plani i mobilitetit të qëndrueshëm për trafikun e motorizuar dhe pamotorizuar të qytetit të Malishevës”. Angl. “Sustainable urban mobility plan for motorized and unmotorized traffic for Malisheva city”.
Kandidati/ja	Bsc. Nurie Paçarizi
Mentori	Prof. ass. dr. Gëzim Hoxha
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 02.05.2024 Vendimi Nr.: 632/3-8

Konkluzion

Punimi i masterit me titull “*Plani i mobilitetit të qëndrueshëm për trafikun e motorizuar dhe pamotorizuar të qytetit të Malishevës*”, i kandidatës BSc. Nurie Paçarizi, i përmbush parakushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike të një punimi të nivelit Master. Punimit i është bashkëngjitur edhe Deklarata e studentit për punë autentike.




Prandaj, në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të Rregullores për studime Master, Komisioni për vlerësim, unanimitisht dhe me kënaqësi i:

Propozon

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Reportin për vlerësimin e punimit për Master me titull “*Plani i mobilitetit të qëndrueshëm për trafikun e motorizuar dhe pamotorizuar të qytetit të Malishevës*”, të kandidatës BSc. Nurie Paçarizi, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë: 11/11/2024

Komisioni:

1. Prof. asoc.dr. Ferat Shala  kryetar
2. Prof. ass. dr. Gëzim Hoxha  -mentor, anëtar
3. Prof. ass.dr. Arlinda Rrecaj  - anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

PËRMBLEDHJA (ABSTRAKTI)

Hulumtimi synon të aplikoj metodologjinë dhe qasjen moderne të trajtimit gjithëpërfshirës të sistemit transportues në mënyrë që të përmirësojë mobilitetin urban dhe sigurinë rrugore për zonën urbane të qytetit të Malishevës. Kjo synohet të arrihet duke u bazuar në praktikat ekzistuese të planifikimit dhe duke marrë parasysh kërkesat reale për lëvizje, çështjen sociale, mjedisore dhe të kursimit të energjisë. Hulumtimi është zhvilluar në disa faza, duke përfshirë:

- fazën përgatitore të planit,
- fazën e grumbullimit të të dhënave,
- fazën e analizës (identifikimin e problemeve ekzistuese, analizën e situatës),
- fazën e zhvillimit të skenarëve dhe përzgjedhjes së skenarit më të përshtatshëm për aplikim, dhe
- fazën e hartimit të planit të veprimit.

Për nevoja të hulumtimit janë përdorur pajisje automatike të matjeve, kamera dhe softuerë profesional aplikativ. Sfidat specifike të transportit dhe sigurisë në trafik me të cilat përballlet Komuna e Malishevës si rrjedhojë e burimeve të kufizuara dhe infrastrukturës jo të mjaftueshme si dhe mungesës së trajtimit gjithëpërfshirës të problematikave të transportit, janë objekt i adresimit në kuadër të këtij hulumtimi. Këto problematika kërkojnë një analizë dhe zbatim të metodave të qëndrueshme dhe efikase për të përmirësuar lëvizshmërinë urbane dhe nivelin e sigurisë në zonën urbane të Malishevës.

Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është të zhvilloj skenarë të qëndrueshëm dhe plan adekuat të masave për implementim në mënyrë që të mundohet mobilitet i qëndrueshëm i trafikut të motorizuar dhe pamotorizuar në zonën urbane të Malishevës.